



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167093

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06354394

KPPP.nr. 1205/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit B.M. B.I, me numër unik identifikues 811308510 dhe me seli në Ferizaj, rr. “Driton Islami”, kundër debitorit “Intering Construction” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810299968 dhe me seli në Istog, rr. “Lidhja e Pejës”, fshati Dobrushë, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme e datës 24.09.2024 si dhe ankesën e datës 24.09.2024, jashtë seancës me datën 25.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET poshtë kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga kreditori B.M. B.I., për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen ankesës ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1205/23, të datës 24.01.2024, si e PASAFATSHME
- II. HEDHET poshtë ankesa e kreditorit B.M. B.I, e paraqitur ndaj Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 1205/23, të datës 24.01.2024, si e PASAFATSHME.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin KPPP.nr. 1205/23, të datës 24.01.2024, ka aprovuar prapësimin e debitorit “Intering Construction” Sh.P.K., të paraqitur ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 42/23, i lejuar me datë 17.03.2023, nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli.

Aktvendimi i kësaj gjykate kreditorit B.M. B.I, i është dorëzuar në adresën në Ferizaj, rr. “Driton Islami”, të cilën kreditori e ka paraqitur si adresë të tij në propozim për përmbarrim, si dhe në regjistrin zyrtar të bizneseve pranë ARBK-së.

Tani me datë 24.09.2024, kreditori ka paraqitur ka paraqitur kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen ankesës, me arsyetimin se vendimin e gjykatës nuk e ka pranuar asnjëherë të vetme dhe se për këtë vendim është njoftuar vetëm nga ana e përmbarruesit privat. Prandaj, gjykatës i ka propozuar që të lejoj rikthimin e afatit në mënyrë që ti mundësohet paraqitja e ankesës ndaj Aktvendimit të gjykatës me të cilin është pranuar prapësimi i debitorit dhe është anuluar urdhri mbi lejimin e përmbarrimit.

Kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme ia ka bashkangjitur edhe mjetin juridik, përkatësisht ankesën e paraqitur ndaj Aktvendimit KPPP.nr. 1205/23, të datës 24.01.2024, me të cilën i ka propozuar Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, që ankesën e kreditorit ta aprovoj si të bazuar, ashtu që të anulohet Aktvendimi i Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale KPPP.nr. 1205/23, të datës 24.01.2024 dhe lënda të kthej në rishqyrtim pranë të njëjtës gjykatë. Poashtu, i ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të ankesës.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se kërkesa e kreditorit për kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e ankesës ndaj a Aktvendimit KPPP.nr. 1205/23, të datës 24.01.2024, është e pasafatshme për shkaqet si në vijim:

Gjykata gjen Aktvendimi i kësaj gjykate KPPP.nr. 1205/23, i datës 24.01.2024, kreditorit B.M. B.I. i është dorëzuar me datë 05.02.2024 në adresën në Ferizaj, rr. “Driton Islami”, të cilën kreditori e ka paraqitur si adresë të tij në propozim për përmbarrim, si dhe në regjistrin zyrtar të bizneseve pranë ARBK-së. Ky fakt vërtetohet nga fletë kthesa e Postës së Kosovës e cila gjendet në shkresa të lëndës.

Ndërsa, kreditori kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e ankesës e ka parashtruar pranë përmbarruesit privat, me datë 24.09.2024, fakt ky që vërtetohet nga vula e pranimi të shkresave e Përmbarruesit privat Mubarak Shumolli.

Me nenin 130, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore, përcaktohet se “*Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin*”, ndërsa me paragrafin 3 të po të njëjtit nen përcaktohet se “*Pas kalimit të*

gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme”.

Prandaj, marrë parasysh faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Aktvendimin KPPP.nr. 1205/23, të datës 24.01.2024, e ka pranuar me datë 05.02.2024, ndërsa kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e ankesës kreditori e ka paraqitur me datë 24.09.2024, rezulton se e njëjta është paraqitur pas kalimit të afatit gjashtëdhjetë (60) ditor brenda të cilit ka mundur të ushtrohet propozimi, dhe si rezultat i kësaj, duke u mbështetur edhe në nenin 17 të LPP-së lidhur me nenin 133 të Ligjit për procedurën kontestimore, i cili përcakton se *“Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit”*, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Në anën tjetër, duke marrë parasysh faktin se me dispozita të LPP-së, nuk është përcaktuar mënyra e vendosjes në rastet kur ankesa ndaj aktvendimit paraqitet jashtë afatit ligjor, në mbështetje të nenit 17 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në procedurën përmbartimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”*, gjykata për vendosjen në rastin konkret zbatoi përshtatshmërisht dispozitat e LPK-së.

Në këtë drejtim, sipas nenit 186, paragrafi 1 të LPK-së, *“Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejueshme e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore.”* Ndërsa, sipas paragrafit 2 të të njetit nen, përcaktohet se *“Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj.”*

Andaj, duke qenë se kreditori aktvendimin e kësaj gjykate e ka pranuar me datë 05.02.2024, ndërsa ankesën e ka parashtruar me datë 24.09.2024, gjykata mbi bazën e dispozitave të cituara, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e hedhur poshtë si të pasafatshme ankesën e kreditorit, pasi që e njëjta është dorëzuar pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar në nenin 77.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”*.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 129, 130, 133.4, si dhe nenit 186 të LPK-së, e në lidhje me nenin 77 të LPP-së, dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1205/23, datë 25.10.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.